



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:051117

Datë: 28.06.2021

Numri i dokumentit: 01928631

C.nr.991/2020

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Besnik Pireva, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses T.SH nga fshati Dobërçan, Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Freskim Musliu avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi zyrtar i lart ligjor në Komunën e Gjilanit, me objekt kontesti kompensim shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 23.06.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet në tërësi e bazuar, kërkesëpadia e paditëses T.SH nga fshati Dobërçan, Komuna e Gjilanit, dhe **detyrohet** e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar (në vlerë të 50% të një page bazë) t’ia paguaj shumën prej 210.50 euro, si dhe në emër të kompesnimit të shpenzimit të ushqimit në punë t’ia paguaj shumën prej 1,332.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 1,542.50 euro, me kamatë ligjore 8%, e cila do të llogaritet nga data 10.04.2020 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses T.SH nga fshati Dobërçan, Komuna e Gjilanit, t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 270 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja T.SH nga fshati Dobërçan, Komuna e Gjilanit, përmes të autorizurit së saj, Freskim Musliu, avokat në Gjilan, në këtë gjykatë me dt.10.04.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, e cila padi dhe kërkesëpadi nga i autorizuari i paditësit është precizuar dhe plotësuar me parashtrësën e dt.11.06.2021, edhe atë para se të caktohej shqyrtimi gjyqësor, lidhur me çështjen juridike kontestimore për kompensim shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit. Në padi ka theksuar se paditësja është e punësuar me kontratë në kohë të pacaktuar në punë dhe detyrat e punës mësimëdhënëse në SH.F.M.U “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit, dhe vazhdon të jetë në pozitë të njejtë, dhe në referencë të dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vazhdim KKAK), nenit 35 parag.

7 dhe 8 të kësaj Kontrate, dhe provave të bashkëngjitura padisë, dhe pas parashtrimit të kërkesës nga paditësi te e paditura, përkatësisht Drejtoria Komunale e Arsimit (në vijim: DKA) në Gjilan, lidhur me realizimin e të drejtës së saj subjektive në procedurën administrative, dhe mos përgjigjes nga e paditura, përkatësisht DKA, iu ka drejtuar gjykatës me padi dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj me kërkesën e përshkruar si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i paditëses, gjatë seancës për shqyrtim kryesor ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë padisë dhe parashtrësës për ndryshimin e kërkesëpadisë, duke theksuar se paditësja në SH.F.M.U “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit prej datës 18.04.2017 deri me datën 16.04.2021 ka qenë e pranishme në punë 666 ditë e për këto ditë i takonë shuma prej 1332 euro, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvoj pune, përkatësisht 50% e pagës bazë, i takon shuma prej 210.50 euro, apo shumën e përgjithëshem prej 1,542.50 euro, me kamatë prej 8% në vit nga data e paraqitjes së padisë, në afat prej 7 ditsësh. I ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore për përgjigje në padi shumën 104 euro, për një seancë të përfaqësuar shumën prej 135 euro si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 31 euro.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj, me përgjigjen në padi si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore në këtë qështje juridike kontestimore, për të vendos lidhur me kërkesëpadinë, ngase e njejta konsideron se kompetente për të vendosur sipas kësaj qështje është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për qështje Administrative, e jo Gjykata Themelore në Gjilan, pasi që e njejta konsideron se pavarësisht se a është përgjigjur apo jo në kërkesën e paditësit DKA-ja, respektivisht e paditura, paditësi ka pas mundësi që mbi bazën e përgjegjes së DKA-së dhe për shkak të heshtjes administrative në afat ligjor ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamentit për Çështje Administrative. Tutje ka theksuar se paditësi kërkesëpadinë e saj e bazon në KKAK, të datës 18.04.2017 të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 7 dhe 8 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit, si e paditur në këtë rast, sepse kjo kontratë nuk është në fuqi, pasi që Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i dt. 06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Si arsye tjetër ka cekur se Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës, i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. E paditura konsideron se kjo kërkesë është vjetruar konform nenit 353 dhe 357 të LMD-së, si dhe nenit 78 të Ligjit të Punës, ngase nuk është adresuar ndonjë kërkesë nga paditësi në procedurën administrative sipas nenit 79 të këtij ligji nga e cila dispozitë parashihet afati prej 30 ditëve për realizimin e kësaj kërkesë. I ka kundërshtua kërkesat e paditëses duke theksuar se të njëjtat kanë arritur për pagesë pas skadimit KKAK-së. Më tej ka theksuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e

lartëcekur, dhe në fund ka shtuar se nuk janë shtjerrë mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditësit, e më decidivisht si në përgjigjen në padi.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Formulari për kërkesë apo ankesë dt.10.02.2020; Kontratën e punës për mësimëshëns në kohë të pacaktuar me nr.283, dt.01.09.2015; Vërtetimin nr.278 dt.23.12.2020; Vëretimin nr.36/2021, dt.27.01.2021; Vërtetimi nr.97/2021 dt.09.06.2021; Vërtetimi 54/2021 i dt.08.02.2021; Vërtetimi nr.99/2021 dt.11.06.2021 dhe Lisata e pagës nga buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditëses me nr. EM00127942.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e punës për mësimëshëns me nr.283, dt.01.09.2015, gjykata ka provuar faktin se paditësja me të paditurën kanë lidhur kontratën e punës për titullin e punës: Mësimdhënëse e mësimi klasor në SHFMU “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit, në kohë të pacaktuar.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit, me numër 99/2021 dt.11.06.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja në këtë shkollë ka 10 vite përvoj pune.

Nga Vërtetimet me nr.36/2021 dt 27.01.2021 dhe 97/2021 dt.09.06.2021 të lëshuar nga SHFMU “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka qenë e pranishme në punë për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 16.04.2021, gjithësejt 666 ditë pune.

Nga Vërtetimi i lëshuar SHFMU “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit, me nr.54/2021 dt.08.02.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se shkolla e lartëcekur nuk ka kuzhinë, dhe asnjë puntor i saj nuk shërbehet në shkollë me ushqim.

Nga Kërkesa me shkrim e paditëses drejtuar të paditurës, e dt.10.02.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja paraprakisht ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe shprëblim jubilar, por e paditura ka heshtur në lidhje me këtë kërkesë.

Nga leximi i listës së pagave të buxhetit të Republikës së Kosovës, me nr.EM00127942, për muajn nëntor 2019, gjykata ka provuar faktin se paditësja ka realizuar nga e paditura pagën bazë prej 421 euro.

Me nenin 90 të Ligjit të Punës, është paraparë se: *1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të*

degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”, ndërsa me nenin 4 parag.2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, sipas nenit 8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”. Sipas nenit 35 parag.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”, ndërsa sipas nenit 35, parag. 8, pika 4 të kësaj Kontrate është përcaktuar qartëse: “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej : për 40 vite të përvojës së punës në vlerë prej 150 % të një page bazë”, pika 8.5 “ Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërbilimit sipas kriterëve përkatëse”. Me dispozitën e nenit 45 të kësaj kontrate është paraparë se “ Nga Kontrata Kolektive, palët mund të rërhien tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisës së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit... ”.

Edhe me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë me numër të protokolit 105 e datës 22.01.2021 e në nenin 35 paragrafi 7 është paraparë se “ Të punësuarve (antarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarëve për ushqim”. Po ashtu edhe në këtë kontratë njëjtë është rregulluar edhe shpërblimi jubilar në nenin 35 paragrafi 8 pika 2.

Në bazë të provave të administura dhe gjendjes faktike të provuar, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe të njëjten e ka aprovuar në tërësi si të bazua, pasi që gjykata ka provuar faktin se: paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe i njëjti punon si mësimdhënëse e mësimin klasor në SHFMU “N.H” në fshatin Dobërçan, Komuna e Gjilanit, dhe realizon të ardhura mujore bazë në shumën prej 421 euro, ka përvojë pune mbi 10 vite, dhe si ditë të pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 16.04.2021, ka 666 ditë të pranisë në punë, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e e kontratave të cekura më lartë,

përkatësisht nenit 35 parag.7 të KKAK-së, gjeti se paditëses i takon e drejta që për ditët e pranisë në punë t'i kompensohet shuma prej nga 2 euro në ditë për ushqim gjatë ditëve në punë, edhe atë për 666 ditë të pranisë në punë, të llogaritur nga 2 euro për një ditë pune i takon shuma prej 1332 euro. Po ashtu, gjykata duke bazuar në nenin 35 parag. 8 pika 8.1 dhe pika 8.5 të KKAK-së, gjeti se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shpërblimin jubilar në vlerë të 50% të një page baze për shkak të përvojës së punës mbi 10 vite, andaj duke llogaritur pagën bazë në shumë prej 421 euro me 50 % të vlerës së saj, rezulton se paditëses i takon e drejta për shpërblim jubilar për lartësinë e aprovuar në shumë prej 210.50 euro.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës lidhur me kundërshtimin e kompetencës lëndore të kësaj gjykate, por gjykata konsideron se kjo çështje juridike është në kompetencë të Gjykatës Themelore, Departamenti i përgjithshëm në Gjilan, e jo në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, pasi që të drejtat dhe detyrimet dhe raportet në mes palëve ndërgjyqëse janë të rregulluara me Ligjin e Punës, e rrjedhimisht edhe me KKAK-në. Për më tepër sipas nenit 2 par. 2 të Ligjit të Punës në mënyrë shpërblimore është cekur: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për qështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”*, e në rastin konkret ligjet e veçanta të cilat e rregullojnë këtë fushë nuk kanë paraparë ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes së kontesteve për këtë kategori të të punësuarve, e rrjedhimisht për vendosjen e këtij kontesti në mes palëve ndërgjyqëse është e kompetencës lëndore kjo gjykatë. Për më tepër, gjykata gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore dhe nga arsyet e cekura më lartë vlerëson se kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të vendosur për këtë çështje kontestimore.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës se paditëses, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi që kërkesa e paditësit është në para dhe jo anulimin apo ndryshimin e ndonjë vendimi të punëdhënësit me të cilin i'jan cënuar të drejtat e tjera paditëses, dhe në rastin konkret nuk gjen zbatim dispozita e nenit 78 të Ligjit të Punës ashtu siç pretendon e paditura, por gjenë zbatim dispozitave nenit 87 i këtij ligji, i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e për më tepër KKAK-ja ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, dhe në bazë të kësaj paditësjë para kësaj kohe nuk ka mundur ta ushtroj këtë kërkesë, pasi nuk kanë qenë në fuqi këto kontratë dhe e njëjta prodhon efekt nga momenti i nënshkrimit të tyre dhe rrjedhimisht të gjitha kërkesat e paditëses janë të afatshme dhe kanë lindur në kohën e zbatueshmërisë së këtyre kontratave.

Sa i përkt pretendimit tjetër se paditësjë e ka bazuar kërkesën e saj pas sakdimi të KKAK-së, gjykata nje pretenim të tillë nuk e mor për bazë nga fakti sen me KKAK-në 2056 të dt.18.04.2017, në nenin 45 është parapar se *“Nga Kontrata Kolektive, palët mund të rërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisësë saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratësë re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t'i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqt asnjëra nga palët, zbatimi i saj vzhdon edhe për një vit...”* e që në rastin konkret e paditura gjykatës nuk i ka ofruar dëshmi, se e njëjta e ka

shfrytëzuar këtë dispozitë të kësaj Kontrate për tu tërhequr nga zbatueshmëria e saj, dhe rrjedhimisht në bazë të kësaj, kërkesa e paditësit është mbuluar me zbatueshmërinë e kontratës së lartëcekur deri me datë 22.01.2021 kur është shfuqizuar kontrata e lartëcekur dhe është lidhë kontrata tjetër kolektive me numër të protokollit 105 e datës 22.01.2021.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës ku ka cekur se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, dhe e njëjta ka sakduar, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 35 pikat 5, 7 dhe 8 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe drejtorëve si dhe pagesës së tyre, e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës. Pos tjerash, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pabazuar edhe nga fakti se Kontrata Kolektive e Arsimit është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të Ligjit të Punës (nenin 90 i këtij Ligji), e po ashtu edhe dispozitën e nenit 2 të kësaj kontrate është paraparë se dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar ku bënë pjesë edhe paditësi. Pastaj është caktuar qartë se dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat-DKA-të, ku në këtë rast është e paditura (neni 2 i KKAK-së). Nërsa me dispozitën e nenit 45 të kësaj kontrate është paraparë se nëse nga Kontrata pasi t'i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vzhdon edhe për një vit, e që në rastin konkret e paditura gjykatës nuk i ka ofruar dëshmi, se e njëjta e ka shfrytëzuar këtë dispozitë të kësaj Kontrate për tu tërhequr nga zbatueshmëria e saj, dhe rrjedhimisht në bazë të kësaj, kërkesa e paditësit është mbuluar me zbatueshmërinë e KKAK-së.

Sa i përket pretendimit tjetër të paditurës ku ka theksuar se në bazë të nenit 90 pika 8 të Ligjit të Punës për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në faqen e MPMS, e njëjta nuk është regjistruar fare në faqen MPMS, dhe si e tillë nuk duhet të prodhojë efekt juridik, po ashtu, gjykata një pretendim të tillë nuk e mori për bazë, sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është relevante se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenit 47 të kësaj Kontrate është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njëjta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme, dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i Kontratës). Sido që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njëjtën ta regjistrojë apo depozitojë, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, e në këtë rast nuk mund të pësojë paditësi.

Gjykata lidhur me kamatëvonesën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe si datë e rrjedhjes së kamatës ka llogaritur momentin i parashtrimit të padisë në gjykatë, me dt.10.04.2020.

Gjykata duke pasë parasysh suksesin në procedurë të paditëses dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463 parag.1 të LPK-së, dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga i

autorizuari i paditëses, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro; në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumë prej 31 euro, dhe në emër të përfaqësimit të paditësit për një seancë shumë prej 135 euro.

Duke pasë parasysh faktin se kërkesëpadia e paditëses ka të bëjë me kompensimim e shpenzimeve për ushqim dhe shpërblim jubilar, e që kontestet e tilla sipas përmbajtjes së padisë, por edhe sipas praktikës gjyqësore nuk rezultojnë të jenë të komplikuar, gjykata me qëllim që gjykimi të jetë sa më efikas dhe ekonomikisht i arsyeshëm, dhe duke u bazuar në nenin 401 LPK-së, ka vendosur këtë qështje kontestimore ta trajtoj nga seanca e shqyrtim kryesor.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.991/2020, me datë 23.06.2021

Gjyqtari,
Besnik PIREVA, d.v

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.